



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21018 Prot.

Lezhë, më 20 . 11 . 2020

V E N D I M

Nr 157, Datë 19 / 11 / 2020

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.46, DATË 13.11.2019 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SE PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1.3, gërma “b”, neni 35, pika 4, neni 54, gërma “f”, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 5, gërma “b”, neni 32, pika 6, në ligjin nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimit, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I:

1. Të bëjë ndryshime dhe shtesa në pikën “I”, gërma “d”, me përshkrimin si më poshtë :
 - d. Autostrada Lezhë-Milot, duke filluar nga kryqëzimi pranë Urës së Re të qytetit Lezhë e deri tek Ura e lumit Mat dhe Austostrada Lezhë-Shkodër, duke filluar nga kryqëzimi pranë Urës së Re të qytetit Lezhë e deri tek ndarja territoriale me Bashkinë Shkodër, në të dy krahët e rrugëve, me distancë 100 (njëqind) metër nga rruga kryesore për secilin krah të rrugës, pavarësisht Njësisë Administrative, që këto segmente rruge i përkasin, do të jenë pjesë përbërëse e Zonës “A”.
2. Të bëjë ndryshimet në pikën “III”, gërma “A”, nën gërma “A.3”, “Taksa e Fjetjes në Hotel”, “niveli i taksës”, duke lënë në fuqi nivelin e taksës referuar “Aneksit 8”, të cituar në “Nenin 26”, të Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

3. Të bëjë ndryshimet në pikën “III”, gërma “A”, nëngërma “A.6”, “Taksa e Tabelës, tabela me përshkrimin “Kategoritë e Tabelave”, tek “Nivelet e taksës sipas kategorive / zërave”, si më poshtë :

N r	Kategorizimi i Tabelave	Njësia	Niveli i taksës		
			Ishte Zonat A,B,C	Bëhet	
				Zona A	Zonat B & C
1	Tabela për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit).				
a	Deri në 2 m²		0	0	0
b	Mbi 2 m² deri ne 10 m²				
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	7.000	2.000	1.000
	Me ndriçim të thjeshtë		10.500	5.500	3.000
	Elektronike		14.000	7.500	5.000
c	Mbi 10 m² deri ne 20 m²				
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	5.950	1.800	900
	Me ndriçim të thjeshtë		8.925	5.000	2.700
	Elektronike		11.900	6.750	4.500
ç	Mbi 20 m² deri ne 40 m²				
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	3.850	1.620	810
	Me ndriçim të thjeshtë		5.775	4.500	2.450
	Elektronike		7.700	6.100	4.000
d	Mbi 40 m²				
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	2.800	1.460	730
	Me ndriçim të thjeshtë		4.200	4.000	2.200
	Elektronike		5.600	5.500	3.600
2	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.				
	Tabela identifikuese	Lekë/m ² /vit	84	42	21
3	Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, deri në tavanin maksimal 35 m².				
a	E thjeshtë (me/pa ndriçim)	Lekë /m ² /vit	15.750	5.000	3.000
b	Elektronike		31.500	25.000	18.000
4	Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë /m ² /ditë	700	350	170

4. Të bëjë shtesat dhe ndryshimet në pikën “B.1”, “Tarifa e Shërbimeve Publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit)”, si më poshtë :

- a. Në pikën “B”, kategoria ”Biznesi”, pika “1”, “Njësi Tregtimi”, shtohet gërma “g”, me përmbajtjen si më poshtë :

N r	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave		
			B.Sipas Xhiros vjetore, në million lekë		
			0-8	Mbi 8	
1	Njësi Tregtare				
g	Tregëtim pemë / bimë natyrale, etj të ngjashëm me to	Lekë / vit	10.000	30.000	

- b. Në pikën “2”, “Njësi Prodhimi”, gërma “ç” “Përpunim Mishi, Peshku”, tek “Emërtesat” dhe “Nivelet e Tarifës”, niveli i tarifës ndryshohet si më poshtë :

N r	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave				
			B.Sipas Xhiros vjetore, në million lekë				
			0-8		Mbi 8		
			Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet	
2	Njësi Prodhimi						
ç	Përpunim Mishi, Peshku	Lekë / vit	50.000	15.000	200.000	40.000	

5. Të bëjë ndryshim të afatit të pagesës, për Tarifën e Shërbimeve Publike, me përshkrimin “Afati i skadencës së pagesës, për Tarifën e Shërbimeve Publike, do jetë si më poshtë”:
- a. Për kategorinë e taksapaguesve “Familjarë”, që nuk kanë kontratë me Agjentin Tatimor të ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife, që është Sh.A.U.K Lezhë, është brenda datës 30 të çdo muaji, të vitit korent. Nëse afati shkelet një herë të vetme, vlera e mbetur paguhet me një kësht të vetëm paradhënie, para ofrimit të çdo shërbimi të kërkuar nga taksapaguesi ndaj Bashkisë Lezhë.
- b. Për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” dhe “Institucione Shtetërore”, është me dy këste të barabarta, brenda datës “30 Prill” dhe “30 Gusht” të vitit korent. Në rast të mos respektimit të afateve të pagesave, veprohet konform ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
6. Të bëjë ndryshime në pikën “B.2.”, “Tarifa për zënien e hapësirave publike”, pika “2”, zona “A”, “B” dhe “C”, si më poshtë :

N r	Kategoria	Njësia	Niveli i Tarifës					
			Ishte			Bëhet		
			Zona A	Zona B	Zona C	Zona A	Zona B	Zona C
2	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me	Lekë /m ² /muaj	500	300	200	200	100	50

kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.							
--	--	--	--	--	--	--	--

7. Të bëjë shtesa dhe ndryshime në pikën “B.3.”, “Tarifa e Parkimit të Automjeteve”, tek “Kategoritë”, “Nivelet e Tarifës”, “Dhënia e Lejes” dhe “Strukturat Përgjegjëse për Vjeljen e saj”, si më poshtë :
- a. Shtesë në pikën “2.2”, gërma “d”, me përmbajtjen “Abone mujore, për Administratën e Bashkisë Lezhë”, tek niveli “Vend Parkim i Miratuar me Pagesë (Vija Blu)”, e cila do ketë nivelin si më poshtë :

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli i tarifës së parkimit
			Vend Parkim i Miratuar me Pagesë (Vija Blu)
2.2	Autoveturë/Taksi (8, 6, 4+1)	Lekë / muaj	
d	Abone mujore, për Administratën e Bashkisë Lezhë.		1.500

- a.1. Kjo tarifë do paguhet paradhënie, e plotë për të gjithë periudhën, që punonjësi ka bërë kërkesën për abonim.
- b. **Dhënia e lejes për parkim** : Në të gjitha rastet e kërkesës së përdorimit të hapësirës publike për parkim të rezervuar për automjete, të çfarëdo lloji qofshin ato, subjekti duhet të drejtohet me shkrim tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, në Bashkinë Lezhë, me kërkesë për t'u paisur me Leje “Për shfrytëzim të Hapësirës Publike për Qëllim Parkimi të Rezervuar”. Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi, nëse kjo sipërfaqe që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti është pjesë e hapësirave publike të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për dhënie për shfrytëzim për qëllime parkimi të rezervuar ose ditore. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialisti i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes subjektit.
- c. **Strukturat përgjegjëse**: Për vjeljen e Tarifës për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike për Qëllime Parkimi të Rezervuar” dhe të “Tarifës për Parkime Ditore” me orë qëndrimi, për automjetet e transportit rrugor, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, në Bashkinë Lezhë.

8. Të bëjë ndryshime në pikën “B.5.”, “Tarifat për Çertifikimin dhe Liçencimin e

Transportit të Udhëtarëve & Mallrave”, tek “Strukturat Përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe Vjeljen e tarifës”, si më poshtë :

a. Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe vjeljen e tarifës : Për hartimin e kritereve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për t’u pajisur me Çertifikatën dhe Liçencën, sipas kërkesës së tyre, konform ligjit dhe VKM përkatëse, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialisti i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, lidhur me llojin e Çertifikatës apo Liçencës. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, e cila, plotëson Liçencën / Çertifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar dhe të konfirmuar për pagesën nga kjo Drejtori ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Juridike. Më pas formati i Liçencës / Çertifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Liçencës / Çertifikatës subjektit.

9. Të bëjë ndryshime në pikën “B.8.”, “Tarifat për Dhënien e Liçencave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për Përdorim nga Konsumatorët Fundorë”, tek “Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe vjeljen e tarifës”, si më poshtë :

a. Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve dhe vjeljen e tarifës : Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, është përgjegjëse për hartimin e kritereve që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për t’u pajisur me Çertifikatën dhe Liçencën, sipas kërkesës së tyre bazuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me nxjerrjen e faturës për arkëtim për vlerën, që detyrohet subjekti sipas nivelit të tarifës përkatëse, të përgatitur nga specialisti i Sektorit të Transportit brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, e cila, plotëson Liçencën / Çertifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar dhe të konfirmuar për pagesën nga kjo Drejtori ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Juridike. Më pas formati i Liçencës / Çertifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Liçencës / Çertifikatës subjektit.

10. Të bëjë shtesat dhe ndryshime në pikën “C”, “Penalitetet / Gjobat”, gërma “b” dhe “c”, me tekstin si më poshtë :

b. Për shkeljet e shënuara në pikën 3 (tre), gërma “a” dhe pikën 4 (katër), është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

c. Për të gjithë penalitetet apo gjobat e vendosura në rastet e konstatimit të shkeljeve të cituara në pikën 1, 2 dhe 3, për të cilat pagesa nga qytetari apo subjekti, kryhet brenda tre ditëve nga data e vendosjes, bëhet zbritje prej 10% të vlerës së penalitetit apo gjobës.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.

12. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

